



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRISË-OPŠTINA VUÇITRAN	
01 Nr. / Br	217/15
Nr. i fq. / Br. st	-21-
Data: / Datum	29. 10. 2015
VUSHTRRI - VUÇITRAN	



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCESVERBAL
NGA MBLEDHJA E -VIII-të E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRISË,
MBAJTUR MË 29 SHTATOR 2015

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar në orën **10:30**.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtri:
Agim Bregaj, Agron Perçuku, Ali Januzi, Arta Ismajli, Bahrije Pllana, Ergin Sunguri, Ermal Lahu, Fakete Dushi, Fatime Haziri, Habib Mustafa, Habibe Gërxhaliu, Ilmi Azemi, Isa Hajrizi, Mehmet Selaci, Mejreme Ismajli, Melihate Basholli, Mentor Ferizi, Mirjeta Salihu, Muharrem Shabani, Myrvete Hetemi, Qerim Selimi, Rrahim Ajeti, Sabri Ferati, Safet Idrizi, Safet Osmani, Selim Rrustemi, Selvete Sholla, Syzana Syla, Shaban Beka, Shpëtim Zhegrova, Tasim Gubetini, Xhevahire Selmani dhe Zoran Rakiç.

Munguan: Hysni Gërguri dhe Shkelzen Feka anëtar të kuvendit.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe kryetari i komunës Bajram Mulaku, nënkryetari i komunës, Dibran Perquku, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Shpëtim Zhegrova – kryesues i kuvendit, i cili vërtetoi se ka shumicë për punë dhe hapi debatin për rendin e ditës.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit-paraqiti tri pika shtesë të rendit të ditës në pikën në të ndryshme, dhe në të njëjtën kohë arsyetoi se këto pika janë shumë të nevojshme që të futen në rend dite për shqyrtim.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit –dha sqarime para anëtarëve të kuvendit lidhur me një lajmë të shfaqur në media. Tutje ai sqaroi se në kohën kur aludohet të ketë ndodhur kjo ngjarje nuk ka qenë Kryetar i Kuvendit të Vushtrisë. Pastaj ai vazhdoi duke sqaruar se në rastin konkret bëhet fjalë për lidhjen e një kontrate mes Kompanisë “Kavaja” dhe një qytetari të fshatit Pasomë për shfrytëzimin e zhavorrit, në pronën private të këtij qytetari, por më vonë bëhet e ditur se ky material është shfrytëzuar në pronë komunale, dhe për këtë çështje është formuar një komision i cili ka dalë në teren dhe ka konstatuar gjendje më të cilën është kërkuar që të ndërpritet puna e shfrytëzimit të kësaj prone, gjë e cila është bërë. Pasatja në ndërkohë është vazhduar shfrytëzimi pa pëlqimin e kryeshefit ekzekutiv në formë tjera nga ana e kryetarit të komisionit është bërë shfrytëzimi i kësaj prone. Pastaj ceku se kryetari i komisionit në bashkëpunim me kryetarin e fshatit kanë dhënë pëlqimin me anë të një kontrate që vazhdohet puna në shfrytëzimin e zhavorrit në këtë parcelë ku këtë kontratë e ka anuluar kryeshefi ekzekutiv por edhe gjykata. Mandej shtoi se në bazë të kësaj kontrate është vazhduar një tjetër kontratë në vitin 2008 ku ai nuk ka qenë në udhëheqje komunale por ka qenë në pushtet një tjetër subjekt politik. Tutje ai njoftoi kuvendin se me këtë çështje nuk ka kurrfarë lidhje dhe se për këtë ka ndërmarr të gjitha masat e duhura dhe se për këtë nuk ndihet përgjegjës. Duke ju referuar hetimit të kësaj çështje ceku se më vonë është konstatuar se hetuesi i kësaj çështje ka

pasuar lidhje familjare me një zyrtarë të prokurimit në komunën tonë dhe gjërave u janë dhënë kaheje të kundërt dhe vlerësimet janë të njëanshme. Në fund tha se ndjen obligim moral që të i informoj se nuk ka pasur kurrfarë lidhje me këtë çështje për interes personal por për kundër ai është munduar të mbroj interesin publik., dhe apeloj që organet e drejtësisë të thonë fjalën e tyre.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit –në emër të grupit kuvendar të PDK-së propozoi që si pikë e veçantë e rendit të ditës të futet propozim për heqjen e taksës në firmë për subjektet ekonomike të Komunës së Vushtrrisë, duke filluar nga 01.01.2016.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit – tha se eksploatimit i shkëmbit në fshatin Pasom është bërë në mënyrë jo të përshtatshme me ç’ rast gjatë periudhës kur është bërë shfrytëzimi i zhavorrit nga eksplozivet e përdorur ka pasur dëmtime (çarje) të shtëpive, dhe me këtë rast qytetarët kanë ngritur padi për kompensim dëmi. Tutje vlerësoi se këtë çështje më së miri e di komuna të cilën duhet ta qartësoj deri në fund, për fakti se në bazë të asaj kontrate kompani në fjalë a ka pasur për obligim që të bëjë shtrimin e rrugës deri në lagjen “Dautaj” dhe nëse ka pasur obligim atëherë komuna duhet të bëjë presion që kjo rrugë të rregullohet. Në fund ai njoftoi se ajo rrugë është dëmtuar mjaft pikërisht nga bartja e gurëve nga kompania në fjalë.

Në përfundim të diskutimeve rreth rendit të ditës, Kuvendi me 24 vota “për” të tjerat “abstenim” aprovoi këtë:

REND DITE

- 1.Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së.
- 2.Shqyrtimi i propozimit për heqjen e taksës në firmë në Komunën e Vushtrrisë.
- 3.Shqyrtimi i Draft-buxhetit dhe planeve investuese për vitin 2016.
- 4.Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomiko-financiare dhe zbatimin e planeve investuese në gjashtëmujorin e parë të vitit 2015.
- 5.Shqyrtimi i Informatës për përgatitje e fillimit të vitit shkollor 2015/2016.
- 6.Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e korrje-shirjeve dhe përgatitjet për mbjelljet vjeshtore.
- 7.Shqyrtimi i Informatës tremujore për sigurinë ushqimore.
- 8.Shqyrtimi i Draft-rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2016.
- 9.Shqyrtimi i Draft-rregullores për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Vushtrrisë.
- 10.Shqyrtimi i Draft-planit pesëvjeçar i menaxhimit të mbeturinave në Komunën e Vushtrrisë 2016-2020.
- 11.Shqyrtimi i Propozim-vendimit për hartimin e hartës zonale në Komunën e Vushtrrisë.
- 12.Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ridestiminin e mjeteve buxhetore të komunës.
- 13.Shqyrtimi i Draft-Planit lokal i veprimit për rini i Komunës së Vushtrrisë.
- 14.Shqyrtimi i Draft-strategjisë për integrimin e komuniteteve jo shumicë në Komunën e Vushtrrisë.
- 15.Shqyrtimi i Informatës lidhur me shpërndarjen e subvencioneve (bletëve) në Komunën e Vushtrrisë.
- 16.Të ndryshme.
16. a). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ridestiminin e mjeteve buxhetore të komunës.
16. b). Shqyrtim i Propozim-vendimit për ndarjen e mjeteve nga fondi për transfere dhe subvencione.
16. c). Shqyrtim i Propozim-vendimit për ofrimin e ndihmës financiare Qendrës për Mbrojtjen e Gruas dhe Fëmijëve “Raba Voca” në Mitrovicë.

1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës Kuvendi me vota unanime aprovoi procesverbalin e mbledhjes paraprake të KK-së.

2. Shqyrtimi i propozimit për heqjen e taksës në firmë në Komunën e Vushtrrisë.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit –tha se në kuadër të këtij propozim kërkoj që të bëhet ndryshimi i rregullores për tarifa dhe ngarkesa dhe gjoba komunale, ku do të hiqen të gjitha ngarkesat dhe taksat për ushtrimin e veprimtarisë afariste dhe atë për të gjitha bizneset që ushtrojnë veprimtari në territorin e Komunës së Vushtrrisë. Gjithashtu ai këtë propozim e arsyeoi se kjo do të ndikoi në mënyrë pozitive në stimulimin e bizneseve dhe rritjen e punësimit. Pastaj ai vlerësoi se një propozim-vendim i tillë nuk do të shkaktoi implikime buxhetore dhe i njëjti do të filloi të zbatohet nga janari i 2016.

Fatime Haziri, anëtare e kuvendit – tha se edhe grupi kuvendar i LDK-së ka kërkuar disa herë që të hiqet taksa në firmë njëjtë se si kanë vepruar edhe komunat tjera. Andaj kërkoi që kjo çështje të analizohet mirë dhe nga viti 2016 kjo taksë të mos ekzistoj më.

Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit – tha se edhe LVV-ja e përkrah këtë propozim për heqjen e kësaj takse, por shtoi se në të kaluarën ka ekzistuar një propozim i kryetarit të komunës që për bankat dhe bastoret sportive kjo taksë duhet të vlej, andaj nëse kjo mbetet në fuqi grupi i LVV-së do ta votoj këtë propozim.

Bajram Mulaku, kryetari i komunës-tha se për heqjen e kësaj takse ka pasur kërkesa prej subjekteve të ndryshme, po tash edhe nga subjekti i tij politik, por mendo se ndoshta bankat dhe lojrat e fatit nuk e meritojnë që të lirohen nga kjo taksë, por se në këtë moment ai e ka bindjen se ky propozim duhet votuar dhe që kjo taksë të hiqet përfundimisht. Tutej duke ju referuar fjalimeve të disa anëtarëve të kuvendit lidhur me çështjen e gurthyesit në fshatin Pasomë ceku se ajo kontratë është lidhur para se ai të merr mandatin e tij si kryetar i komunës. Pastaj ai njoftoi se i fundi operator ekonomik i quajtur “Rrukoll” i cila ka pasur një kontratat me komunën ka pasur për obligim të bëjë rregullimin e rrugës Sllatin- Pasomë dhe ku dimensionet e asaj rruge kanë qenë 4m gjerësia kurse gjatësia 2km, kurse ai si kryetar i komunës në atë kohë ka vlerësuar se ajo rrugë është rëndësisë së veçantë dhe e njëjta duhet të jetë gjerësisë prej 5m, e që është dashur të bëhet ndryshimi i asaj kontrate në dimensionet e rrugës që nga 4 metra sa ishte paraparë të bëhet 5 metra dhe të ndërtohet në gjatësisë për sa m² do të zvogëloheshin dhe konvertoheshin në gjerësinë e rrugës andaj kjo ka qenë e vetmja kërkesë e tij për ndryshimin e asaj kontrate. Tutja njoftoi se ky ndryshim është zbatuar në kontratë dhe rruga është ndërtuar, por e njëjta fatkeqësisht është shkatërruar nga i njëjti operator ekonomik kurse ky operator ka si obligim kontraktues që bëjë rindërtimin e asaj rruge. Lidhur me këtë çështje ai i ka bërë shkresë kompanisë në fjalë duke ja kujtuar se ka për obligim që ta bëjë riparimin e kësaj rruge, dhe se për këtë të gjitha përgjegjësit i mban kjo kompani për kthimin në gjendje të mëparshme të kësaj rruge. Pastaj ai vlerësoi se ka informata jo zyrtare që kompania “Rrukoll” i ka shitur një tjetër kompanie këtë projekt. Mandej sa i përket rrugës Sllatinë-Tarllabuq e cila është dëmtuar dhe mund të thuhet se ky projekt ka dështuar që ka qenë një projekt shtesë në një segment të saj që është dëmtuar, dhe për këtë çështje është zhvilluar proces gjyqësor dhe komuna e ka fituar këtë kontest, por edhe garancionin që e ka pasur e ka marr komuna, dhe kështu që komuna do ti bëjë të gjitha përpjekjet që ta rregulloj këtë rrugë.

Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit –tha se kur bëhet fjalë për gurthyesin në fshatin Pasomë, mund të thuhet që operatori e ka përfunduar marrjen e atij materiali i cili është në pronë publike, kurse tani ai eksplauton në pronë private dhe tani ka përfunduar ky proces, dhe tani ky operator ka obligim që rregulloj rrugën e cila është e shkatërruar plotësisht. Tutje ai vlerësoi se pasi që ky operator ekonomik operon edhe në projektet tjera në komunën tonë është mirë që ky operator të kushtëzohet nga komuna duke mos iu dhënë të hollat pa e rregulluar këtë rrugë.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 23 vota "për" 4 "kundër" të tjerat abstenim vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendim lirohen nga pagesa e taksës në firmë të gjitha subjektet afariste të cilat e ushtrojnë veprimtarin e tyre në territorin e Komunës së Vushtrrisë.

2.Ndryshimet sa i përket lirimit nga pagesa e taksës në firmë sipas këtij vendimi duhet të inkorporohen në tekstin e Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale 01.Nr.330/12 të datës 27.12.2012.

3.Për zbatimin e këtij Vendimi obligohet: kryetari i komunës dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4.Ky Vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

3.Shqyrtimi i Draft-buxhetit dhe planeve investuese për vitin 2016.

Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit – tha se buxheti për vitin 2016 për Komunën e Vushtrrisë nuk dallon nga buxhetet e viteve të kaluara. Shumica e parave shkojnë për paga dhe mëditje ndërsa pak mjete mbesin për investime. Nga ato mjete për investime infrastruktura vazhdon me marrë pjesën kryesore dhe nga ndarjet buxhetore për vitin 2016 Qytetarët e Vushtrrisë nuk mund të presin shumë. Ne si Lëvizje Vetëvendosje! e kemi analizuar këtë buxhet dhe si i tillë nuk paraqet dhe garanton asnjë lloj zhvillimi. Janë përjashtuar kategori si rinia, sporti, bujqësia si një degë shumë më rendësi për komunën tonë. Ka disa ndarje por janë të pa mjaftueshme dhe nuk i përmbushin kërkesat e qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë. Pastaj ceku se në buxhetin për vitin 2016 ka disa ndarje me të cilat pajtohet plotësisht Lëvizja Vetëvendosje! që janë të nevojshme dhe me rendësi për Qytetin e Vushtrrisë dhe fshatrat e tij. Por si tersi lenë shumë për të dëshiruar. Nuk do të ndalem në detaje përveç që do të ju njoftoj se edhe për vitin 2016 nuk kemi shpresë që gjendja ka me ndryshuar as në aspektin e zhvillimit, as atë kulturorë e as që në mirëqenie e punësim. Natyrisht që vota jonë do të shkoj kundër!

Bahrije Pllana, anëtare e kuvendit –në emër Grupit të Grave Delegate kërkoj 5 minuta pauzë për konsultim.

Pas pauzës prej 5 minutave Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë i vazhdoj punimet:

Bahrije Pllana, anëtare e kuvendit-tha se pas konsultimeve që kanë pasur me Grupin e Grave Delegate, kanë arritur në pajtueshmëri që nga Zyra e Kuvendit të Komunës të barten 5000€, për financimin e nevojave të GGD-së.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit-tha se pas bisedave që kanë pasur me përfaqësuesen e Grupit të Grave, kanë arritur pajtimin që fondi për mallra dhe shërbime në vlerë prej 10,000€ i zyrës së kuvendit të shpenzohet bashkërisht me Grupin e Grave Delegate duke i financuar projektet të cilat do të sërvohen nga zyra e kuvendit dhe GGD-ja.

Bajram Mulaku, kryetari i komunës-tha se duhet pasur parasysh faktin se parat e buxhetit shpenzohen vetëm me planifikim, ku gjithçka duhet të jetë e specifikuar, për faktin se nga Ministria e Financave kemi kërkesa strikte ku gjithçka duhet të jetë e emërtuar saktë se ku po shpenzohen mjetet në cilin projekt si për investimet kapitale ashtu edhe për mallrat dhe shërbimet. Andaj ai në fund i apeloj GGD-së që për rritjen e fondit duhet të kenë projekte konkrete të specifikuara, dhe propozoi që fondin prej 10,000€ bashkërisht ta shpenzon zyra e kuvendit dhe GGD-ja.

Fatime Haziri, anëtare e kuvendit – tha se grup parlamentar i LDK ka disa vërejtje te ky draft buxhet ,sidomos te investimet kapitale:

-Infrastruktura publike

Pika 7 -Gypa kanalizimi –në çdo vjet po ndajmë mjete për gypa kanalizimi dhe kurrë nuk po njoftohemi se kujt po i jepen dhe kemi shume ankesa nga qytetaret se këta gypa kujt po i ndahen, andaj si grup parlamentar kërkojmë listën e atyre që përfituesve.

Pastaj pika 8,9 dhe 10 ku kemi ndërtimi i urave, ndriçimit publik dhe gjelbërimi i hapësirave publike duhet te ceket vendi ku është planifikuar të ndërtohen këto, dhe jo vetëm te jepen shumat shabllon e këto të ndërtohen sipas shijes se dikujt që i konvenon.

Pika 12 ndërtimi i varrezave të dëshmorëve ,edhe këtu kemi informacione se ne krahasim me mjetet qe po ndahen për këtë kategori shume të ndejshme. Puna qe po kryhet ne krahasim me shumen e mjeteve qe po jepet për çdo vjet është shumë e vogël.

Mandej në fushën e bujqësisë po ashtu kemi shume ankesa te qytetarëve se po u jepen shume donacione njerëzve partiak pa i plotësuar kriteret e përcaktuara nga vete drejtoria dhe ne asnjëherë nuk po njoftohemi se kush po i merr këto donacione edhe ne raportin final te shpenzimeve vazhdimisht po fshihen këto lista te përfituesve.

Tek Drejtoria e Kadastrës kemi një shume prej 80.000.00 euro për shpronësim por nuk po ceket ku do të shpronësohet apo edhe këtu po caktohet paushall shuma pa e planifikuar ku do te shpronësohet.

Tek Drejtori e Planifikimit Mjedisor dhe Inspektimet kemi një shume prej 1. 065.835.00 për asfaltimin e rrugëve lokale ne fshatra pa e specifikuar se ne cilat fshatra do të asfaltohen, shtrohet pyetje për çka behet planifikimi i buxhetit a do të përfitojnë te gjithë qytetaret e komunës sonë pa dallim përkatësie partiake.

Lidhur me shëndetësia shuma për pajisje medicinale prej 10.000.00 euro po na duket shume simbolike për nevojat shëndetësore.

Pastaj tek Drejtoria e Kulturës Shuma për inventar për qendrën rinore dhe bibliotekën është shume e madhe ,kjo duket si me u furnizua me inventar prej fillimi e jo ndërrim i inventarit jo funksional ,kurse për palestrën sportive qe disa vjet po pikon kulmi dhe po dëmtohet parketi nuk keni planifikuar qe ta rregulloni.

Tek arsimi mendon se nuk ka nevoja për blerje te veturës se edhe ashtu komuna ka shume vetura dhe disa i keni marre si donacione dhe vetëm po rriten shpenzimet e mirëmbajtjes se veturave.

Te ndërtimi i fushave sportive e kemi një disproporcin në shuma kur dihet se fushat sportive për sportet e vogla janë standarde ne dimensione çka është duke ndodhur këtu.

Në fund tha se kemi mungesë të ndarjes se subvencioneve për arsim parashkollor dhe çerdhet.

Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit –tha se kemi një disproporcion të shpenzimeve mes qeveris komunale dhe kuvendit kur dihet fakti se vetme për dreka dhe mëditje qeveria shpenzon afro 40,000€, kurse për zyrën e kuvendit janë ndarë vetëm 10,000€. Pastaj ai vlerësoi se blerja e veturave për komunë nuk duhet të jetë prioritet për faktin se vetuar komuna ka mjaft por duhet të orientohet në blerjen e ndonjë autoambulance për të cilën QKMF-ja por edhe spitali ka mjaft nevojë.

Ermal Lahu, anëtar i kuvendit–në emër të lagjeve të fshatit Galicë para anëtareve të kuvendit lexoj një letër drejtuar kryetarit të komunës Drejtorit të Drejtorisë së Urbanizmit dhe kryesuesit të kuvendit e cila ka të bëjë me asfaltimin e rrugës në lagjet Hamiti, Shabani dhe Lahu të fshatit Galicë, të cilët kanë kërkuar që për vitin 2016 në planifikim buxhetor të futet si projekt asfaltimi i kësaj rruge në gjatësi prej 700m dhe e gjerë 3m.

Arta Ismajli, anëtare e kuvendit- tha se duke pasur parasysh që në fshatin Gumnishtë janë asfaltuar rrugët e lagjeve te këtij fshati lagje këto të pa banuara përderisa lagjja “Ismajli” e cila është me e banuar ne krahasim me lagjet tjera nuk është asfaltuar.

Pavarësisht prej faktit se këta banor ishin ndër banoret që participuan më së shumti për projektin fillestar dhe që kishin marr premtimin se rruga që lidhe Gumnishten me fshatin Bare do të kaloj përgjatë lagjes së tyre por që kjo gjë nuk ndodhi.

Tutje shtoi se këta banor kane kërkuar disa herë që të behet asfaltimi i kësaj rruge në mënyrë që t'iu lehtësohet jeta në këtë fshat por që tash e sa vite nuk kanë gjet përkrahje nga komuna.

Dhe tani në Draft Buxhetin komunal për vitin 2016 shihet që kjo rrugë prapë nuk ka hyrë në prioritet për vitin e ardhshëm dhe që kjo është e papranueshme, për faktin se kjo rruge nuk ka një kosto të madhe dhe që është vetëm 1700 metra dhe se kjo kërkesë e banoreve po shtyhet nga viti në vit.

Në fund ajo kërkojë nga kryetari i komunës, drejtorja përkatëse dhe delegatet që kjo kërkesë të përkrahet dhe të futet në prioritet për vitin 2016, pasi që fjala është vetëm për 1700 metra atëherë le të gjendet forma nga drejtorja dhe kjo të futet në planifikim për vitin 2016.

Myrvete Hetemi, anëtare e kuvendit-tha se sa i përket planifikimit urban në faqen 6 nr. 13 lidhur me asfaltimin e rrugëve në fshatin Ashlanë në lagjet "Shermetit, Hyseni dhe Mani" është planifikuar që për vitin 2016 që këto rrugë të asfaltohen, kurse në të vërtetë këto rrugë janë të përfunduara. Tutje ajo njoftoi për një problem në rr. "Selatin Hyseni" që lidhet me emërtimin e kësaj rruge. Pastaj ajo duke ju referuar themelimit të Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave të për Emërtimin e Rrugëve, ceku se ky komision duhet të punojë më tepër pasi që ka shumë probleme lidhur me emërtimin e rrugëve. Mandej ajo kërkoj përgjigje se përse ky komision nuk është duke e kryer punën e tij dhe më këtë po shkakton edhe më tepër probleme. Në fund ajo tha se mjetet e planifikuara për asfaltimin e rrugëve në fshatin Ashlan ato mjetet të transferohen në rregullimin e rrugës "Selatin Hyseni".

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit -tha se nëse e analizojmë gjendjen shihet se kemi mjaft shumë kërkesa por mundësitë buxhetore janë të limituar e që thënë më pikërisht është e pamundur që të gjitha këto kërkesa të realizohen me buxhetin e vitit 2016. Tutje shtoi se në këtë drejtim duhet pasur një parim e ai është trajtimi i barbare të komuniteteve në çdo mes pa dallime për të gjithë qytetarët. Tutje shtoi se parimi apo elementi tjetër i cili do të duhej merrej parasysh është shkalla e inksimit të tatimit në pronë për faktin se ai është burim afatgjatë i të hyrave të komunës. Në vazhdim ai duke krahasuar buxhetin e këtij viti me vitet paraprake shohim se kemi një buxhet restriktiv dhe jo zhvillimor krahasuar në vitin paraprak ku më tepër kemi kategori tjera të rritura të mjeteve se sa shpenzimet kapitale derisa në vitin e kaluar kemi pasur 3,699.901€ investime kapitale, kurse për këtë vit i kemi 3,404,040.00€ e që i bie që për këtë kategori kemi afro 250.000€ më pak se vitin e kaluar, pastaj kemi rritje tek subvencionet si dhe tek shpenzimet për komunalitë ku vitin e kaluar kemi pasur 14.374.85€ kurse për këtë vit kemi 231.000.00€, mandej kemi rritje tek mallrat dhe shërbimet 1.421.000.00€ i kemi sivjet kurse vitin e kaluar i kemi pasur 1.184.000.00€ diferenca në rritej është afro 300.000€, andaj në këtë rast po shohim që ajo kategori që po insistojmë tash ajo e investimeve kapitale është në rënie e sipër në këtë vit. Pastaj ai vlerësoi se ekzekutivi komunal duhet të bëjë përpjekje që të zvogëloj shpenzimet, dhe ceku se edhe auditori ka konstatuar se akujt nuk i lejohet ndërrim i destinimit të mjeteve dhe kjo ka ndodhur në komunën tonë dhe kjo mundë të cilësohet si keqpërdorim i atyre mjeteve. Në vazhdim ai ceku se duhet të kemi një specifikim për shumën e mjeteve të destinuara për asfaltimin e rrugëve në vlerë prej 1,065,835.00€ dhe në këtë rast duhet në mënyrë taksative të kemi listën e këtyre rrugëve dhe specifikat e tyre. Pastaj për shumën prej 141,413.00€ të dedikuara për ndërtimin e kanalizimeve edhe për këto projekte duhet të kemi listën detal me specifikat dhe emërtimin e këtyre projekteve, mandej rregullimi i argjinaturave të lumenjve duhet të specifikohen se ku do të ndodhin këto investime. Gjithashtu ceku se është shumë i nevojshëm specifikimi i projektit të ndërtimit të shkollave duke u bazuar në kriteret e madhësisë së shkollës sipërfaqes dhe numrit të nxënësve dhe mos të kemi vetëm shuma totale pa specifikacion. Në fund ai shprehu pakënaqësinë e tij lidhur me mos përfshirjen e disa rrugëve në planifikim buxhetor siç është rruga e quajtur "Naser Hajrizi", dhe mos rregullimi i kësaj rruge sigurisht se e shëmton qytetin, pastaj në çoftë se disa lagje në fshatin

Brusnik në vitin 2012 kanë qenë në prioritet lagjja “Peci” pastaj “Ferizi” dhe lagjja “Hajdari” janë projekte të cilat duhet të futen në listat e rrugëve dhe rregullohen.

Selvete Sholla, anëtare e kuvendit –tha se në këtë draft-buxhet njëmend ka shumë gjëra të pa çarta, dhe shtoi se tek projekti rregullimi i lumit “Tërrstena” edhe sa herë do të ndajmë mjet për këtë projekt, pastaj shtroj nevojën e rregullimit të shtratit të lumit “Podrança” për faktin se nga vërshimet lumi del nga shtrati. Në fund ajo shpreh aneksen e saj se draft-buxhetit i komunës për këtë vit është hartuar vetëm nga grupi kuvendar i PDK-së kurse grupet tjera nuk janë ftuar të marrin pjesë

Bajram Mulaku, kryetari i komunës-tha se komuna jonë ka pranuar nga Ministria e Financave tri qarkore buxhetore radhazi dhe kjo e fundi më e rëndësishmja, andaj me kohë zyrtaret kompetent kanë filluar fazën e planifikimit të buxhetit komunal për vitin 2016. Tutje shtoi se me qarkoren buxhetore shihet se kemi rritej të buxhetit në raport me vitin e kaluar rritej e cila kryesisht manifestohet në kategorinë e pagave dhe mëditjeve. Pastaj vlerësoi se rritja e pagave vitin e kaluar ka reflektuar në zvogëlimin e mjeteve në disa vija tjera buxhetore e në veçanti në kategorinë e investimeve kapitale, dha atë zvogëlimi ka ndodhur në vlerën diku afro 800.000€, dhe kjo nuk është bërë nga ana e udhëheqjes komunale por nga Ministria e Financave. Pastaj ai njoftoi kuvendi se me qarkoren e fundit kemi një rritje të limit të investimeve kapitale krahasuar me qarkoret e mëparshme dhe kjo ka ndodhur për faktin se ka ekzistuar një limit i mbikëqyrjes së investimeve nga Banka Botërore. Në vazhdim ai duke ju referuar anëtarëve të kuvendit ceku se vitin e kaluar kuvendi i komunës ka aprovuar projektet dy dhe tre vjeçare, dhe kjo ka bërë që me këtë planifikim të futen këto projektet të cilat duhen të vazhdohen edhe në këtë vit fiskal. Mandej ceku se planifikim buxhetor për vitin 2016 është 14,587,091.00€ dhe nga Ministria e Financave kemi shkurtim të subvencioneve ku në vitin e kaluar kemi pasur një vlerë rreth 220,000.00€ kurse për këtë vit kemi 182,914.00€. Tutje ceku se kuvendi i komunës ka hartuar Strategjinë Lokal të Zhvillimit Ekonomik dhe me këtë dokument prioritet i është dhënë zhvillimit të bujqësisë dhe pikërisht për këtë komuna ka shkuar duke i rritur subvencionet në bujqësi prej vitit në vit, ku vitin e kaluar për subvencione në bujqësi kanë qenë të planifikuara 197, 000.00€, për këtë vit 330,000.00€, kurse vitin e ardhshëm ka propozuar që subvencionet për bujqësi të jenë në vlerën afro 400,000.00€. Andaj në këtë kuadër si rezultat i rritjes së këtyre subvencioneve, kanë mbetur pa u realizuar disa projekte kapitale që kanë qenë dy dhe tri vjeçare. Kurse obligime nga investimet kapitale për vitin 2016 i kemi 1,574,550.00€, ndërsa për marrëveshje të ndryshme kryesisht me donator të jashtëm 338,284.00€ e që totali i obligimeve për vitin 2016 është 1,912.834.00€. Pastaj investime kapitale për vitin 2016 janë planifikuar 3,404,040.00€ kurse diferenca është mbetur të realizohet në investime kapitale. Andaj nëse e analizojmë këtë buxhet atëherë mundë të themi se buxheti nuk është i atillë që të mund ti përmbush të gjitha nevojat dhe kërkesat e qytetarëve. Duke folur për procedurën e hartimit të buxhetit, njoftoi se gjatë fazës së planifikimit janë mbajtur dëgjimet buxhetore të organizuara nga Komiteti për Politikë dhe Financa, mandej se është dhënë ideja në komitet, që secili grup kuvendar të jep propozimin lidhur me këtë projekt-buxhet, mirëpo propozime konkrete ka pasur vetëm nga ana e qytetarëve por jo edhe nga ana e grupeve kuvendare. Në vazhdim ai duke ju referuar diskutimeve të anëtarëve të kuvendit ceku se kur bëhet fjalë për ndërrim të destinimit të parave publike ato nuk kanë ndodhur dhe ceku se nuk do të lejon që ato të ndodhin, por nëse ka pasur ndonjë veprim të tillë atëherë ata zyrtar do të japin përgjegjësi para organeve kompetent. Pastaj tek specifikimi i projekteve kapitale ceku se për këto projektet shuma e mjeteve është specifikuar, kurse emërtimi i projekteve nuk është bërë për shkak se në të shumtën e tyre kemi vazhdim të projekteve dy dhe tre vjeçare, dhe ajo listë e atyre projekteve ekziston dhe ajo mund të servohet edhe para anëtarëve të kuvendit, për aprovim. Mandej ai përsërit se propozimi i shpenzimit të mjeteve për investime kapitale që është dhënë ky propozim duhet të racionalizohet në vite 2016/2018 me fjalë të tjera duhet të ndahet për faktin se kemi mungesë të mjeteve dhe shpërndarja e këtyre projekteve duhet të racionalizohet dhe proritizohet. Pastaj njoftoi se në

planifikimin e të hyrave vetanake nuk kanë planifikuar mjetet nga legalizimi i objekteve pa leje e që pritet që ka me pasur të hyra relativisht të mira nga kjo fushë. Tutje ceku se pasi që ligji për faljen e borxheve ka hyrë në fuqi ai do ta afektoj edhe kategorinë e tatimit në pronën e paluajtshme, dhe kjo mendon se do të shkaktoj një "invazion" të pagimit të borxheve nga debitorët për faktin se në të kundërtën do tu mbetet borxhin nga e kaluara dhe kjo do të ndikoj në ngritjen e të hyrave komunale. Andaj konform këtyre pritjeve ka shpresë reale që edhe projektet e vitit 2017 do të realizohen më herët. Pastaj kur flitet për rehabilitimin e fushave sportive në fshatin Smrekonic propozoi që kjo të shtohet edhe në fshatin Stroc, pastaj në renditje e nr. 11 ndërtimi i fushës sportive në shkollën fillore "Çajup" ku janë paraparë 34,000.00€ njoftoi se në këtë lokacion është duke u ndërtuar ambulanta e re dhe ky ndërtim e ka atakuar fushën ekzistuese sportive kështu që kemi qenë të detyruar të ndërtojmë një fushë të re sportive. Në këtë kontekst propozoi që në këtë tabelë të futet rehabilitimi i fushës sportive në fshatin Smrekonic, Stroc andaj në faqen nr. 7 të draft-buxhetit në rubrikën 11 të hiqet shuma prej 8,000€ dhe të vendoset në rubrikën 12 që destinohen në rehabilitimin e fushës sportive në fshatin Smrekonicë dhe të shtohet edhe fshati Stroc. Mandej në faqen 6 të dokumentit në fjalë në rubrikën 13 mendo se ka një gabim lidhur me emërtimin e këtij projektit "asfaltimi i rrugës në fshatin Ashlan lagjet Sheremeti , Hyseni Moni" kjo rrugë e ka emrin "Selatin Hyseni" Në fund tha se tek tabela 4.2 e buxhetit kodi 920 arsimit dhe shkenca rubrika "rehabilitimi i fushës sportiv në fshatin Smrekonicë" të shtohet edhe fshatrat Stroc, Novolan dhe Pestovë, që në fshatin e parë të realizohet projektit gjatë vitit 2016 kurse në fshatrat tjera realizimi i projekteve bëhet nga mjetet që teprjnë nga projektet tjera.

Shpresa Rama, drejtoresh e DKRS-së-paraqiti sqarime lidhur me ndërtimin e palestrës sportive në fshatin Samadrexhë i cili është projekt dy vjeçar i financuar nga Ministria e Kulturës, ku për të njëjtë kuvendi ka ndarë një parcelë për ndërtimin e këtij objekti.

Bajram Mulaku, kryetari i komunës-në përgjigjen e anëtares së kuvendit Fatime Hazirit, ceku se rruga në fshatin Sllatin ka nevojë për rehabilitim sidomos segmenti i parë nga qytetit e deri tek fshati Pasomë dhe mendon se ky projekt do të mund të realizohet nga vija buxhetore "rehabilitimi i rrugëve" dhe shtoi se nëse është vullneti i kuvendit do të mund që ky propozim të futet në draft-buxhet për vitin 2017, por do të bëjnë përpjekje që ky projekt të realizohet gjatë vitit 2016, andaj ceku se kishe me qenë mirë që kjo rrugë të futet në planifikim në këtë shtyllë buxhetore dhe pastaj të shikohet mundësia e realizimit të këtij projektit sa më parë që të jetë e mundur.

Syzana Sylja, anëtare e kuvendit – tha se tek ndërtimi i pullazit të shkollës fillore "Naim Frashri", pyeti se a ka mundësi financiare që për këtë projekt të ndahen mjete edhe për ndërrimin e dyerve dhe dritareve pasi që janë mjaft të dëmtuara.

Bajram Mulaku, kryetari i komunës-tha se rregullimi i shkollave është prioritet komunale dhe shtoi se dy shkolla janë rinovuar falë donacioneve ndërkombëtare dhe atë shkolla fillore "Çajupi" dhe shkolla në fshatin Stanoc të cilat janë realizuar nga donacionet e USAID.

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së- paraqiti sqarime të përgjithshme lidhur me draft-buxhetin komunal për vitin 2016, duke shtuar se me të marr qarkoren buxhetore Komuna e Vushtrrisë ka filluar fazën e planifikimit të buxhetit për vitin 2016. Pastaj njoftoi se tek kategoria e pagave dhe mëditjeve jo vetëm komuna jonë por edhe komunat tjera ka një deficit kurse lidhur me orientimet dhe shpërndarjet tjera buxhetore të gjitha janë kryer me kohë.

Bajram Mulaku, kryetari i komunës-duke u përgjigjur në pyetjen e anëtarit të kuvendit Habib Mustafa, bëri të dituar se komuna ka pas planifikuar dhe realizuar një projekt për ndërtimin e rrjetit të ujësjellësit në fshatrat e Çiçavicës dhe një gyp është shtri në fshatin Akrahticë deri në fshatin Bukosh përgjatë vijës hekurudhore, dhe e mira e krejt kësaj është që ne tani na është dhënë një donacion nga CDI-ja në vlerën afro 1,000.000€ dhe për këtë është nënshkruar marrëveshja dhe tani është duke u hartuar projekti detal për shtrirjen e rrjetit të ujësjellësit në të gjitha fshatrat e rajonit të Artakollit, dhe nga kjo komuna ka për obligim që të ndërtoj një *basene* mbi fabrikën e ujësjellësit që me anë të pompave të shtyhet uji në atë basen

që më rënie të lirë të furnizohen me ujë edhe tri fshatrat e rajonit të Drenicës Galicë, Beqiq dhe Duboc. Në këtë kontekst njoftoi që deri në fund të vitit 2017 ky projekt mendohet se do të përfundojë. Gjithashtu në këtë kuadër bëri të ditur se për renovimin e ujësjellësit ekziston edhe një projekt tjetër donacion nga organizata lux development në vlerë prej afro 900,000.00€ dhe se ky projekt në saje të bashkëfinancimit ka filluar dhe është duke u realizuar në rrugën afër komunës.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit –në fund të debatit propozoi që të hidhet në votim draft-buxheti komunal për vitin 2016, me propozimet e dhëna nga kryetari i komunës.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 18 vota “për” 6 vota “kundër” të tjerat abstenuan vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendim aprovohet buxheti i Komunës së Vushtrrisë, KAB-i dhe lista e projekteve kapitale për vitet 2016-2018, konform Qarkoreve Buxhetore të lëshuara nga MF-ja.

2.Shuma e përgjithshme e buxhetit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2016 është 14,587,091.00 €, prej të cilave për:

- Paga.....9,348,009.00 €.
- Mallra dhe shërbime.....1,421,086.00 €.
- Komunalitë.....231,042.00 €.
- Subvencione.....182,914.00 €.
- Shpenzime kapitale.....3,404,040.00 €.

Githsejt:.....14,587,091.00 €.

3.Të hyrat vetanake të planifikuara.....1,703,418.00 €.

4.Mjetet financiare të cekura në piken 2 dhe 3 të këtij vendimi janë në pajtim me Qarkoren Buxhetore 2016/03 të MF-së në bazë të kufijve të dhënë.

5.Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe organet tjera kompetente.

6.Tabela 4.1- Plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale të komunës për vitin 2016 (faqe 1-5); Tabela 4.2 – Investimet kapitale në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2016-2018 (faqe 1-5); Tabelën 4.3 (1); janë pjesë e këtij vendimi, të bashkëngjitura në shtojcë.

4.Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomiko-financiare dhe zbatimin e planeve investuese në gjashtëmujorin e parë të vitit 2015.

Arta Ismajli, anëtare e kuvendit- tha duke u bazuar ne raportin gjashtë mujor për gjendjen ekonomiko financiare dhe zbatimin e planeve investuese dhe duke u bazuar në fjalën kryetarit të komunës qe në fund të këtij raporti thuhet se i mirëpret sugjerimet, vërejtjet dhe propozimet. Konsideroj se në raport janë përfshirë shume angazhime të komunës për të cilat do te kishte nevojë që të kemi informata më të detajuara ne seancat tjera te kuvendit.

Tutje shtoi se tabela e shpenzimeve e cila është paraqite për periudhën raportues të jep me kuptua se në baze të përqindjeve të paraqitura ka drejtori apo kategori të ndryshme buxhetore që për këtë periudhe ka shpenzuar me pak buxhet se sa qe është planifikuar.

Në këtë kontekst domosdoshmërisht lindi pyetja se ku janë shkaqet a nuk kemi pas planifikim real apo ka mungese kapacitetesh menaxhereale.

Se pari kur mund të kemi raport të detajuar të shpenzimeve buxhetore te cilat në detaje do të paraqitnin shpenzimet e që është kërkesë e saj tashme e përsëritur sepse atëherë ne kishim me pas mundësi me pa realisht shpenzimet.

Në këtë raport po mungon informata për personelin e komunës për të cilin ka pyje dhe kërkoj informate me shkrim:

Informate për koeficientet e punëtorëve të administratës me qellim që të shihet se a ka dallime, Sa punëtor të administratës janë me kontrata të përhershme dhe sa me kontrata të përkohshme—nëse ka kontrata të përkohshme pse ka ndodhe kjo kërkoj arsytim.

Pastaj tek prokurimi një informate se a ka operator ekonomik të cilët nuk kanë përmbushur obligimet e kontratave ?

Gjithashtu te arsimi çdoherë po kemi informata dhe raporte për suksesin dhe disiplinën e nxënësve, kërkoj qe nga drejtoria përkatëse që të bëjë një hulumtim dhe analize për disiplinën dhe performancën e mësimit në raport me përmbushjen e detyrave dhe obligimeve të tyre që tash nuk dëshiroj të konstatoj por kemi nxënës të cilët në takime me ta ne dhe familjet tona thonë shume here se nuk kanë mbajtur ore në mungese të mësimit.

Pastaj shtoi se e ka theksuar edhe ne seancat e kaluara se për kulturën, rinin dhe sportin do të duhej të shtohen fondet dhe kjo drejtori të ndihmonte më shumë në ngritjen e kapaciteteve qe kanë për qellim fuqizimin e politikave dhe aktiviteteve për kulturën, rinin dhe sportin.

Kam kërkuar më shume angazhim e programe kulturo-artistike sidomos në teatër, dhe menaxhim më të mire të palestrës dhe terreneve sportive.

Në fund duke i falënderuar për mirëkuptimin konsideroj se përpos punëve të mira që janë kryer ka nevojë për më shume angazhim transparence dhe llogaridhënie të të gjitha kategorive të cilat janë nën menaxhimin e komunës.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit – tha se ky raport është mjaft voluminoz në kuptimin tekstual sikur të ishte raport vjetor e që ndoshta nuk është edhe aq e nevojshme ta hartohet nja raport kaq voluminoz. Tutje duke ju referuar të dhënave të paraqitura në këtë raport shihet se investimit kapitale janë të realizuara shumë pak vetëm 12% dhe shpresojmë që tre muhori i fundit i vitit do ta ndryshoj situatën në të mirë. Në këtë segment mund të thuhet se në shëndetësi kemi pasur të planifikuara 186,000.00€, kurse janë realizuar vetëm 2,981.00€ të realizuara, mandej shërbimet kontraktuese ku një shumë e tyre është e pa përcaktuar, pastaj një element tjetër i cili duhet të hyjë në shpenzime është mirëmbajtja rutinore të cilën nuk e kupton se çfarë është e cila është në vlerë prej 38,170.00€. Tutje duke ju referuar gjithnjë të dhënave të paraqitura në raport ceku se edhe tek infrastruktura komunale kemi një realizim shumë të ulët ku prej 791,121.90€ kemi të realizuara vetëm 137,000.00€, tek bujqësia prej 367.000.00€ kemi të realizuara 78,000.00€, mirëpo edhe shpenzimet tjera janë bukur të mëdha. Prandaj vlerësoi se kemi nevojë që të kemi shfrytëzim racional të mjeteve por njëkohësisht të kursejmë shpenzimet, ku ato në krahasim me vitin paraprak në disa lëmi janë të rritura ku mesatarja për dreka zyrtare i bie të jetë për çdo muaj nga 2,000€ kurse mesatarja për ditë pune 1,00€ pastaj, e që marrë në tërësi kemi një rritje të shpenzimeve prej 17,000.00€ më shumë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Gjithashtu e veçanta e rritjes së shpenzimeve është tek uji dhe kjo nuk e di nëse është rritur çmimi i ujit por shihet se kemi ndryshime të mëdha në këtë drejtim dhe ceku se duhet kushtuar vëmendje kurimit të mjeteve dhe të rritim përpjekjet për rritjen e inksimit të të hyrave. Andaj në fund tha se nuk do të lëshohet në raportet tjerat të dhëna në mënyrë tekstuale sepse shihen rezultatet dhe të arriturat të paraqitura në mënyrë taksative nëpër drejtorit kompetente por se kemi nevojë për ndryshime kjo është evidente dhe në këtë kontekst kërkoj mobilizim të përgjithshëm të përpjekjeve për realizimin e të gjitha atyre projekteve kapitale.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës-tha se e ndan mendimin se ndoshta nuk ka qenë shumë e nevojshme që të kemi shumë tekst të paraqitur në këtë raport, por se nga diskutuesit paraprak kishte kundërtënie ku njëri kërkoj që të ketë më tepër sqarime tekstuale për ato që thuhet në raport, kurse tjetri kishte mendimin që kemi shpjegime tekstuale të tepruara, andaj mund të

thuhet se është bërë praktik që raportet e këtilla të hartohen në këtë formë. Tutej shtoi se në referim të ligjit jemi të obliguar që të paraqesim raport vetëm për shpenzimet buxhetore e jo edhe për punën nëpër drejtorit komunale, por sido që të jetë në këtë raport janë paraqitur të dhëna edhe për punët në drejtorit dhe në këtë drejtim mendon se nuk ka asgjë të keqe. Pastaj vlerësoi se kur bëhet fjalë për shpenzimet jo të mjaftueshme të planifikuara pajtohet se ndoshta planifikimi nuk është bërë në mënyrë adekuate por se mund të thuhet se projektet janë zhvilluar por pagesat akoma nuk janë kryer edhe tani ka kaluar një periudhë e gjatë prej se ka kaluar gjashtë mujori i parë i vitit, por sidoqoftë akoma ka nevojë që të punojmë në realizimin e pagesave. Pastaj duke arsyetuar se buxheti ka një kaheje të duhur në realizim ceku se në Drejtorin e Urbanizmit gati të gjitha projektet kapitale që kanë të bëjnë me asfaltimin e rrugëve dhe ndërtimin e kanalizimeve janë realizuar apo janë në realizim e sipër dhe e njëjta vlen edhe për shërbimet publike, por se përsëriti se shumica e pagesave akoma nuk janë kryer e që kjo ndikon që në raport të del që buxheti nuk është realizuar në masën e duhur. Mandej njoftoi se disa komisione të cilat janë ngrit për pranimin teknik të disa projekteve akoma nuk kanë përfunduar dhe pikërisht për këtë nuk mund të bëhen pagesat. Në këtë kontekst shtoi se gjithsesi është e rëndësishme që pagesat të kryhen me afat por më e rëndësishme është përfundimi i projekteve. Tutje njoftoi se kanë pasur përvojë të mirë në shpenzimin e buxhetit posaçërisht të granteve qeveritare për të cilat është rreziku se nëse nuk shfrytëzohen me kohë shkojnë në suficit në buxhetin e Kosovës, kurse sa i përket të hyrave vetanake kemi hapësirë sepse këto mjete mund të barten në ndonjë projekt tjetër. Tutje duke u përgjigjur në pyetjet e anëtarëve të kuvendit sqaroi se pozicioni mirëmbajtje rutinore nënkupton mirëmbajtjen e rrugëve kurse, sa i përket shpenzimeve për dreka zyrtare arsyetoj se kemi bërë përpjekje maksimale për uljen e shpenzimeve, por se në disa raste për disa delegacione të jashtme për komunitat e binjakëzuara me komunën tonë si dhe për ditën e dëshmorëve janë bërë shpenzime për dreka dhe kjo ceku se është plotësisht e arsyeshme. Pastaj lidhur me shpenzimet e telefonisë ceku se ato janë ulur për faktin se punëtorët e administratës komunale ata të arsimit dhe shëndetësisë hyrë në rrjetin e operatorit "Vala" dhe thirrjet i kanë pa pagesë.

5. Shqyrtimi i Informatës për përgatitje e fillimit të vitit shkollor 2015/2016.

Myrvete Hetemi, anëtare e kuvendit- Kur flasim për fillimin e vitit shkollor 2015/2016, duam të theksojmë që edhe ky vit është duke u përcjellë me parregullsi qysh nga mos shpallja publike e vendeve të lira të punës e konkurseve për mësimdhënës, qoftë në shkollat fillore e po ashtu edhe në ato të mesme.

Ta zëmë në Gjimnazin "Eqrem Qabej", janë disa raste në të cilat punojnë mësimdhënës të cilët nuk e kanë përgatitjen e duhur profesionale të kërkuar me Udhëzim Administrativ.

Këto shkelje janë vazhdueshme në komunën tonë. Mos shpallja e këtyre vendeve të lira të punës është shkelje ligjore.

Habib Mustafa, anëtar i kuvendit-tha se informata është mirë e hartuar por, shqetësuese në këtë informatë është mungesa e rezultateve sidomos në dy shkollat teknike i cili rezultat duhet të ndryshohet për faktin se kalueshmëria në testin kombëtar në këto dy shkolla është 39 respektivisht 59%, ndërsa me gjimnazin kemi një përqindje të mirë që tregon se kemi një kualitet në mësim nxënie, dhe kjo tregon se kjo shkollë është një ndër shkollat më të mira në Republikën e Kosovës. Tutje duke aksentuar lidhur me ekskursionet që po organizohen për në Shqipëri ceku se me këto organizime nxënësit nuk janë duke përfutuar fare porse në këtë rast përfitues janë vetëm kompanitë që merren me këtë çështje. Pastaj ai vlerësoi se këto ekskursionet nuk kanë ndonjë vlerë për faktin se nuk vizitohen monumentet historike dhe i njëjti po shkakton shpenzime bukur të mëdha për familjet tona të varfra. Andaj në fund duke referuar lidhur me këtë çështje propozoi që të mbahen takime me prindërit e nxënësve dhe këto ekskursionet të mos organizohen në të ardhmen.

Qerim Selimi, anëtar i kuvendi- tha se çështja e organizimit të ekskursioneve është e rregulluar me udhëzim administrativ, dhe ai si pjesë e një komisioni në Ministrinë e Arsimit ka tentuar që këto çështje të ndalen dhe këto evenimente të mos organizohen. Tutej shtoi se këto çështje bien në domenin e kompetencave të shkollave ku së bashku me DKA-të në saje të kërkesave të shkollave organizohen këto ekskursione. Pastaj lidhur me rregullshmërinë e organizimit të këtyre ekskursioneve mund të thuhet se komuna jonë është e dalluar në nivel të Kosovës. Në fund ai tha se të gjithë ata të cilët kanë argumentet për shkelje ligjore lidhur me shpalljen e konkurseve për mësimdhënës dhe lidhur me organizimin e ekskursioneve është mirë që ato argumente të paraqesin në organin e prokurorisë.

Melihate Basholli, anëtare e kuvendit- tha se në informatë figuron që shkollat e komunës janë furnizuar me lëndë djegëse, dhe pyeti se a është rregulluar nxehja qendrore në shkollën SHMU2.

Musaj Terbunja drejtor i DA-së-paraqiti sqarime të përgjithshme lidhur me informatën në fjalë duke u përgjigjur në pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

6. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e korrje-shirjeve dhe përgatitjet për mbjelljet vjeshtore.

7. Shqyrtimi i Informatës tremujore për sigurinë ushqimore.

Bahrije Pllana, anëtare e kuvendit- pyeti se cilat masa janë ndërmarr lidhur me gjetjen e produkteve me afat të skaduar. Pastaj pyeti se në rastin e urdhrit për dezinfektimit, dezinfektimit dhe deratizimit cilat veprimet janë ndërmarr ndaj atyre të cilët nuk i janë përmbajtur këtij urdhri. Tutej shtoi se në informatë ceket se është inspektuar ndërmarrja regjionale e ujësjes në Vushtrri, gjë e cila kishte ndodhur edhe në informatën e kaluar dhe ishte shqiptuar e njëjta vërejtje, me këtë rast gjendja është e njëjtë andaj apeloj që të shqiptohet ndonjë gjobë në këtë drejtim. Pastaj ajo vlerësoi që në këtë informatë kishte me qenë mirë që Drejtoria e Inspektiveve të na njoftoi edhe për vështirësitë me të cilat ajo ballafaqohet në terren, me ç' rast dihet se kësaj të fund i mungojnë mjetet e ekzekutimit si dhe ka mungesë të inspektorëve adekuat.

Selvete Sholla, anëtare e kuvendit- duke krahasuar informatën tremujore për sigurinë ushqimore me atë paraprakën ceku se këto dy informata janë krejtësisht të njëjta me përjashtim të datave me të cilat janë proceduar për në kuvend. Tutej duke ju referuar informatës në fjalë ceku se pasuesi ku njofton se *asgjësimi i mallit është bërë me detyrim të inspektorit në peshë prej 327.40kg* ku e njëjta shifër dhe i njëjti shpjegim është dhënë në informatën e kaluar e që i bie se kjo informatë është e njëjta dhe se vetëm është përshkruar nga ajo e kaluara. Pastaj ajo paraqiti vërejtje për sa i përket kompanisë regjionale të cilës prapë i jepen afat prej 30 ditëve dhe kjo prej muajit mars kure edhe atëherë i ishin dhanë afat prej 30 ditëve prapë është përsëritur i njëjti afat, andaj edhe në këtë rast asgjë nuk është ndërmarr as edhe një veprim. Mandej ceku se i vetmi ndryshim tek kjo informatë është tek paraqitja e tabelarit të fundit ku: *procesverbalet e lëshuara kanë qenë 84, 162, fletëparaqitje proporcioni 5 ai paraprak kurse informata aktuale 12*, por se është interesant dhe i çuditshëm është fakti që pesha e produkteve të asgjësuar është e njëjta sikurse në tremujorin e parë sikur në këtë tremujorë 369.70 kg. Në fund ajo duke aksentuar lidhur me këtë çështje tha se nuk ka qenë e nevojshme të na përshkruhet e njëjta informatë nga ajo e kaluara, dhe ngrit çështjen si majtë shqetësuese të ekspozimit të produkteve ushqimore përpara dyqaneve duke pyetur *''se a është duke i parë ndokush këto gjëra apo jo''* dhe produktet tjera ushqimore të cilat u vendosen tiketë mbi tiketë, apeloj që këto gjëra të inspektohen e jo të sillen përshkrimi i informatës së njëjtë.

Agim Bregaj, anëtar i kuvendit-tha se sistemi i sigurisë së produkteve ushqimore është një çështje nacionale sistematike e bazuar shkencërisht për të siguruar siguri ushqimore duke u bazuar në tri faza themelore: identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve shëndetësore në të gjitha

fazat e prodhimit, përpunimit dhe shpërndarjes së ushqimit, specifikimi i masave në kohën e duhur për të parandaluar rreziqet e identifikuar, sigurimi i zbatimit të masave parandaluese, përcaktimi kryesor i ushqimit të shëndetit tonë pra siguria shëndetësore dhe ushqimi i shëndetshëm dhe i sigurt cilësia e ushqimit si dhe parandalimi i cenimit të shëndetit të konsumatorëve, rreziqet kryesore ndaj shëndetit të konsumatorëve që në radhë të parë vijnë nga shkaqet fizike kimike dhe mikrobiologjike, pastaj mbrojtja efektive e shëndetit e konsumatorëve nënkupton rëndësinë e eliminimit të dukurive negative të materieve helmuese në kohë të duhur të ushqimit të kontaminuar dhe jo efikas. Sëmundjet me origjinë ushqimore janë njëra nga problemet më të mëdha të shëndetit publik. Tutje shtoi se është skandaloze dhe shumë negative në cilësi të shumta të lidhura me ushqimin prezantohet p.sh sëmundja e “e lopës së çmendur”, pastaj sëmundjet hormonale, përdorimi i antibiotikëve në masë të madhe, metalet e rënda dioksinat si dhe sëmundjet mikotike. Në fund tha se dëshiron të dijë që inspektorët sanitar në komunën tonë sa janë të ndërgjegjshëm dhe a e kryejnë ndonjë punën të tyre lidhur me asgjësimin e këtyre elementeve negative a paraqesin ndonjë fletë-dendonim apo ndonjë gjobë për këtë çështje imediate në asgjësimin e produkteve ushqimore kush e kryen? Dhe a janë të licencuar këto grupe dhe a kontrollohen nga dikush a ka ndonjë padri ndaj Ujës-jellësit Regjional lidhur me korrodimin e gypave si dhe a kontrollohet gjendja higjieno-sanitare e furrave të bukës, gjellëtoreve, qebaptoreve si dhe a është kryer dezinfektimi, deratizimi dhe dezinfektimi i objekteve dhe depove të mallrave dhe lokaleve ushqimore në komunën tonë.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit –tha se dëshiroj të ri potencoi se raporti i paraqitur nga Drejtoria e Inspektimeve është parashtrua për periudhën 01.01.2015 deri me 07.09.2015, ndaj lidhur me konfuzionin lidhur me mallin e asgjësuar në vlerë prej 369.70kg sqaroi se kjo nuk është se këtij malli i ka dal afati në shtije por është se bizneset e kanë deklaruar si mall të cilit i ka skaduar afati. Tutej ceku se me ligjin për tregtinë e brendshme çdo operator ekonomik që i afrohet afati i skadimit për mallra të caktuara është i obliguar që mallin ta tërheq prej shitjes duhet të që produkti i tillë të ndahet në një vend të caktuar jashtë përdorimit dhe duhet të njoftohen organet e inspektimit, kurse inspeksioni është i obliguar të hartoj procesverbalin pastaj caktohet lokacioni dhe kështu bëhet asgjësimi i produktit të caktuar. Në këtë kontekst vlerësoi se në rastin konkret bëhet fjalë për periudhën e parë të raportimit ku pesha e mallit të asgjësuar ka qenë 369.70kg, dhe se në periudhën e dytë nuk ka pasur asgjësim, andaj këto gjëra zakonisht raportohen në fund vit apo në janar nga ana e kompanive, pasi të njëjtat mbahen në stok në depo për shkak të detyrimit të pagimit të tvsh. Gjithashtu ai tha se Drejtoria e Inspektimeve ka vepruar drejt kur ka dhënë afate shtesë për faktin se çdoherë lufta duhet të zhvillohet në preventiv. Pastaj lidhur me dezinfektimin dezinsktimin dhe deratizimin ceku se mund të thuhet se asnjë komunë nuk e ka gjendje më të mirë se sa Komuna e Vushtrrisë, ku të gjitha lokalet duke përfshirë furrat e bukës, qebaptoret, marketet si dhe depot po thuaj se të gjitha këto subjekte afariste kanë kontrata me kompanitë të cialt merren me dezinfektimin dezinfektimin dhe deratizimin e këtyre hapësirave, dhe këto procese kryhen në mënyrë të rregullt.

8.Shqyrtimi i Draft-rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2016.

Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit – tha se në leximin e parë në seancën e kaluar të rregullores për tatimin në pronë ua rikujtuam kërkesën e vitit të kaluar që ishte edhe kërkesë në muajin e kaluar dhe që është kërkesë edhe në këtë seancë, që duke iu referuar draft rregullores në fjalë, bazuar në nenin 6.4 të Ligjit për kategoritë e dala nga lufta lirohen nga pagesa e tatimit në pronë këto kategori: Familjet e dëshmorëve, Invalidët e UÇK-së, Invalidët civil të luftës dhe Familjet e viktimave civile të luftës që janë në gjendje të rëndë ekonomike.

Tutje shtoi se, është pa kuptimtë se përse Komuna e Vushtrrisë po heziton që ta inkorporojë këtë nen i cili do t'u shërbente këtyre kategorive që t'u lehtësohej pak a shumë gjendja e tyre

ekonomike. Është për tu habitur se si pa fije turpi Drejtoria përkatëse as që e merr mundin ta shqyrtojë këtë kërkesë. Shumë shpesh po dini të thirreni në luftën e UÇK-së, në gjakun e derdhur në këtë luftë, në lirinë që na solli kjo luftë por kur po vjen puna që t'i përkrahim ata që na sollën këtë liri, dhe që derdhën gjakun e tyre, ju bëheni sikur nuk po dini gjë.

Prandaj, ne sikur në seancat tjera edhe në këtë seancë kërkojmë që ky nen të inkorporohet në këtë draft rregullore dhe këto kategori të lirohen nga pagesa e tatimit në pronë, sepse është e drejtë e tyre, e garantuar me Ligj. Edhe njëherë ia bëjmë me dije drejtorit që shumë komuna e kanë futur këtë nen në draft rregulloret e tyre, e ndër to edhe komuna e Skenderajt.

Nëse nuk futet ky nen në këtë rregullore, ne do të votojmë kundër.

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së- paraqiti sqarime të përgjithshme lidhur me draft –rregulloren e Tatimit në Pronën e Paluajtshme. Duke shtuar se akoma nuk kemi harmonizim të ligjit nga ana e nivelit qendror si dhe akoma nuk kemi autorizim zyrtar nga qendra për lirinë e këtyre kategorive nga pagesa e tatimit në pronën e paluajtshme.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit – tha se është obligim ligjor që kuvendi për çdo vite të aprovojë rregulloren e tatimit në pronën e paluajtshme. Tutej ai shtroi si çështje me mjaft interes çështjen e kriterëve për kategorizimin e zonave tatimore, për faktin se ndarja e zonave ka mbetur e tillë qysh prej përfundimit të luftës, duke mos i marrë për bazë të gjitha investimet në rrethe të caktuara të qytetit, të cilat investime kanë ndryshuar jetën e qytetarëve. Pastaj ai ritheksoi se pjesa e qytetit nga vendi i quajtur “ura e hekurit” pjesë në të cilën është investuar shumë në infrastrukturë duke filluar nga rruga, trotualet, ndriçim publik, gjelbërimi si dhe ndërtimi i shkollave dhe institucioneve shëndetësore e bëjë këtë pjesë mjaft atraktive dhe e njëjta figuron në zonën e dytë tatimore në bazë të rregullores, gjë e cila nuk është reale për faktin se kjo zonë në bazë të investimeve të cilat janë bërë është dashur të jetë në zonën e parë. Andaj apeloj tek drejtoria kompetente që të shikohen këto gjëra dhe të ndryshohen pasi siç dihet tatimi në pronë është një e hyrë dhe burim i fuqishëm në buxhetin komunal.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 21 vota “për” 2 vota “kundër” të tjerat abstenim vendosi me sa vijon:

Aprovohet Rregullorja për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2016.

9.Shqyrtimi i Draft-rregullores për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Vushtrrisë.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 23 vota “për”, të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:

Aprovohet Rregullorja për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Vushtrrisë.

10.Shqyrtimi Draft-planit pesëvjeçar i menaxhimit të mbeturinave në Komunën e Vushtrrisë 2016-2020.

Argon Përçuku, anëtar i kuvendit-tha se ky draft-plani i quajtur për menaxhimin e mbeturinave është më tepër një raport statistikor se sa një planë i mirëfilltë për menaxhimin e mbeturinave. Ai tutje pyeti se a din ata që janë marr me këtë problem se si bëhet një planë i tillë cilët janë hapat paraprak të cilët duhet të ndermirren për hartimin e tij. Pastaj pyeti se cilët janë akteret bartës të këtij dokumenti dhe se a është zhvilluar ky planë në kuptimin e sensibilizimit të qytetarëve lidhur me menaxhimin e mbeturinave, si do të jetë ajo fushata sensibilizuese në sa etapa do të ndahet ajo cilat do të jenë aktivitetet që do të ndërmerren a do të organizohen debate publike a do të ketë fushatat vetëdijesuese nëpër shkolla mandej a do të ketë takime sensibilizuese me lagjet të qytetit si dhe si do të bashkëbisedoni me komunitetin për këtë problem madhorë. Pastaj ai pyeti se me cilët ekspert mjedisor ka bashkëpunuar

komuna në hartimin e këtij plani dhe me cilët do të bashkëpunoni për këtë problem kaq emergjent. Tutej a keni bërë plane financiare për këtë strategji kur dihet se për këtë qëllim nevojiten mjete për realizimin e fushëveprimit të këtij plani, fushatën vetëdijësuese, pastaj analizën e mbeturinave në burim, procesin e ndarjes së mbeturinave në kontejner të veçantë etj. Tutej nga do të sigurohen mjetet e resurseve njerëzore a do të jenë ata *“militant partiak”* apo ekspert të mirëfilltë nga kjo fushë.

Islam Latifi, zyrtar i DSHP-së-paraqiti një rezyme të përgjithshme lidhur me dokumentin në fjalë duke dhënë përgjigje për çështje e ngritura nga anëtarët e kuvendit.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit –propozoi që tek tabela nr. 14 pika 2 e këtij dokumenti të bëhet ndryshimi tek zonat komunale të ndahen në 2 zona e jo në 3 zona komunale siç është aktualisht

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 23 vota “për” të tjerat abstenim vendosi me sa vijon:

1. Me këtë Vendim aprovohet Plani Pesëvjeçar i Menaxhimit të Mbeturinave për periudhën 2016 – 2020.

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria e Shërbimeve Publike.

3. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është dokumenti me emërtimin “Plani Pesëvjeçar i Menaxhimit të Mbeturinave 2016 - 2020”.

11.Shqyrtimi i Propozim-vendimit për hartimin e hartës zonale në Komunën e Vushtrrisë.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 25 vota “për”, të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendim lejohet hartimi i Hartës Zonale e cila përfshin më hollësishëm llojin e destinimit dhe shfrytëzimin e planifikuar të hapësirës në territorin e Komunës së Vushtrrisë.

2. Harta Zonale e Komunës së Vushtrrisë përfshin një periudhë kohore 2015-2023 me mundësi vazhdimi.

3. Obligohet Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit që të ndërmer masat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi në pajtim me ligjet dhe aktet tjera në fuqi të cilat rregullojnë këtë çështje.

12.Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ridestiminin e mjeteve buxhetore të komunës.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 23 vota “për”, të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendim bëhet ridestnimi i mjeteve nga buxheti i komunës në shumën prej 20,000.00€ nga fondi 10 (grantit qeveritar), nga kategoria e investimeve kapitale, sipas tabelës 4.2, kodi i programit 470, Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

2. Nga projektet e cekura në piken 1 të këtij vendimi ridestinohen mjetet sipas tabelës 4.2 e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

3.Për zbatimin e këtij Vendimi obligohet: Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

13.Shqyrtimi i Draft-Planit lokal i veprimit për rini i Komunës së Vushtrrisë.

Arta Ismajli, anëtare e kuvendit- tha se Plani i Lokal i veprimit rinor i cili është me siguri i bazuar ne Ligjin Nr. 03/L-145 “Për Fuqizimin dhe Pjesëmarrjen e Rinis” dhe “Strategjinë Kosovare për Rinin 2013-2017” është një dokument i rëndësishëm për rinin e qytetit tone dhe qëllimi ynë i përbashkët është që nëpërmes këtyre dokumenteve të krijojmë sa me shumë mundësi që të rinjtë të zhvillojnë aktivitetet e tyre në të gjitha sferat e jetës ku ata janë të interesuar.

Tutje shtoi se ky dokument që po them prapë se është i rëndësishëm për të rinjtë dhe pa dyshim që do të përkrahet konsideroj se është e nevojshme që të përmendi disa çështje te cilat përpos vullnetit të mire mos të jemi ata që e dëgjojmë çdo here atë thinjën e famshme dhe demagogjike se “Rinia është e ardhmja jone”.

Qe mos të mbetet vetëm një thëne e tille besoj se është e nevojshme qe shume kush të jap kontributin e tij për këtë dokument të rëndësishëm.

Se pari konsideroj se dokumenti ka elemente të trajtuara bukur mire por ndoshta mua po më duket që ky dokument ka më shume elemente të një strategjie ose politikë lokale për rinin dhe dizajmim të aktiviteteve, se sa që është Plan i Veprimit Rinor.

Ky plan së pari është dashtë të ketë një strategji për rinin e Komunës së Vushtrrisë dhe më pas te hartohet Plani i veprimit për rinin.

Titulli i draftit bien në kundërshtim me atë që shkruan më vonë në faqen e pare ku thuhet “ si i tille ky dokument i politikave rinore i pasuar nga plani veprimit rinor“.

Dhe tash kemi dileme a është vetëm plan i veprimit rinore apo është edhe strategji ose politike rinore, apo të dyja bashke.?

Tek objektiva e pjesëmarrjes në vendimmarrje propozoj të largohet pjesa ku thuhet te rinjtë ftohen në takimet konsultative të kuvendit Komunal nëpërmes DKRS/Sektori i rinise, por duhet të jete ftohen të marrin pjese në takimet konsultative të KK-së

E kam të pa qarte çështje se pse duhet komuna të udhëheqë me zgjedhjet dhe strukturimin në Këshillin e veprimit rinor lokal edhe pse kështu mund të jete në udhëzime të ndryshme të Ministrisë për Kulture, Rini dhe Sport.

Në këtë kontekst konsideron se është jo normale që organizatat që jenë të regjistruara si OJQ dhe veprimtarinë e tyre e zhvillojnë të pavarura si shoqëri civile, (Ligji Nr. 04/L-57 për Lirinë e Asocimit në Organizata Joqeveritare).

Pastaj çështja e pjesëmarrjes së organizatave rinore ne organet e KK-së janë të rregulluara dhe vetëm është dashtë që në këtë dokument te motivohen, bile aty ka shprehje edhe si bordi i drejtoreve qe më nuk ekziston me ligjin për vetëqeverisje lokale dhe statutin e komunës.

Me një fjale në pjesëmarrjen e organizatave rinore të gjitha institucionet duhet të jene të hapura për pjesëmarrjen e tyre, propozimeve, iniciativave dhe zotimi se institucionet dhe organizatat rinore janë partnere dhe do të ndihmohen në zhvillimin e aktiviteteve të tyre etj

Pa dashtë që të hyjë në çështje tjera të cilat konsideroj se për secilën objektiv mund të sugjerohet diçka me qëllimin më të mire që më të vërtet dokumenti të jete i punuar mire dhe i realizueshëm unë në fund dëshiroj të potencojë këto çështje të cilat janë të rëndësishme dhe të merren edhe si propozime te mijat me qellim te mirë:

Të përpunohet ende ky draft dhe kuvendi ta aprovoj në seancën e radhës me këto ndryshime.

Të definohet qartë a është Plan i veprimit rinor, strategji lokale e rinise apo të dyja bashkë.

Të rishikohet buxheti i aktiviteteve sepse unë dëshiroj shume që ky dokument të ketë për tre vitet këtë buxhet 147.200.00€ e që komuna duhet të ndaj 85.600.00 €, por mund të pyetemi a është e mundshme kjo!

Sepse nëse në fund e aprovojmë këtë dokument dhe nuk i kemi këto mjete financiare nuk duhet të harrohet se ky është një dokument publik dhe ne mbajmë përgjegjësi.

Në fund ajo tha se për këtë dokument që të aprovohet nga KK-ja me qëllim të krijimit të kushteve sa më të mira për të rinjtë tanë dhe konsideroj se hartuesit dhe propozuesit e këtij dokument do të më mirëkuptojnë sepse jam për një dokument i cili në tre vitet e ardhshme do të realizohet e jo të mbetet në letër.

Shpresa Rama, drejtoreshë e DKRS-së- tha se sa i përket asaj se përse ky dokument quhet plan e jo strategji është për faktin se ky plan është bazuar në Strategjinë Kosovare për Rinin 2013/2017 e që kjo praktik është ndjekur nga të gjitha komunat e Kosovës. Në vazhdim ajo dha sqarime shtesë lidhur me këtë dokument.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 24 vota "për" të tjerat abstenim vendosi me sa vijon:

1. Me këtë Vendim aprovohet Plani i Veprimit për Rini i Komunës së Vushtrrisë.

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

3. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është dokumenti me emërtimin "Plani i Veprimit për Rini".

14. Shqyrtimi i Draft-strategjisë për integrimin e komuniteteve jo shumicë në Komunën e Vushtrrisë.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

1. Jepet në diskutim publik Draft-Strategjia Komunale për Integrimin e Komuniteteve jo shumicë 2016/2021.

2. Diskutimi publik fillon nga data 05 tetor 2015 dhe zgjatë deri më 20 tetor 2015.

3. Obligohet Zyra Komunale për Informim që të ndërmer masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për transparencën në komuna, dhe konform nenit 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.

4. Obligohet Komisioni Komunal për hartimin e këtij dokumentit që si hartues dhe propozues i Draft-Strategjisë në fjalë të organizoj diskutim publik konform Udhëzimit Administrativ për transparencë në komuna Nr. 05/2013, dhe nenit 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.

Gjithashtu komisioni i sipër cekur obligohet që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantoj Kuvendit të Komunës me rastin e shqyrtimit të dytë të Draft-Planit në fjalë në mbledhjen e KK-së në muajin tetor 2015.

15. Shqyrtimi i Informatës lidhur me shpërndarjen e subvencioneve (bletëve) në Komunën e Vushtrrisë.

Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit – tha se pasi lexuam me shqetësim të madh informatën për subvencionim me bletë nga Komuna e Vushtrrisë, tek ne lindën disa pyetje në të cilat do të donim të na përgjigjeshit.

Pyetja e parë është: Cilët janë hapat ligjor që do të ndiqen ndaj furnizuesit?

Këto bletë të blera të cilat rezultuan të infektuara: a ka gjasë që këto t'i kenë infektuar bletët ekzistuese të bletarëve përfitues dhe të bletarëve të tjerë. Nëse po, kush do të bëjë kompensimin e dëmit të tyre? Dhe në fund, kërkojmë ta dimë se kush do të mbajë përgjegjësinë për këtë gjë? **Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit**-deklaroi se nuk vend për shqetësim për arsye se vërtet se në rastin e bletëve ka ndodhur një import në mënyrën më të mirë të mundshme ku në mënyrë të rregullt janë kryer të gjitha procedurat e importit, mirëpo për sqarimin tuaj dhe të opinionit theksoi se kontraktimi me operatorin ekonomik ka shkuar në bazë të procedurave dhe se importi është bërë në bazë të pikave doganore dhe importuesi ka poseduar deklaratat ashtu siç i precizon ligji i Maqedonisë si dhe inspektori sanitar i AVUK-it. Pastaj certifikata janë lëshuar se importi mund të lejohet, pas kësaj me urdhër të inspektoratit të AVUK-ut është urdhëruar komuna që të gjegjësisht operatori ekonomik që të dërgojë bletët në karantinë për 14 ditë në mënyrë që të përcillet gjendja e tyre shëndetësore, kjo është historia dhe AVUK pas 14 ditësh e ka dhënë lejen për me u zhvillu procedura e shpërndarjes së bletëve. Tutej shtoi se kjo sëmundje edhe më parë kishte qenë prezent tek ne në rastin tonë janë asgjësuar disa bletë kurse, lidhur me përgjegjësin mund të thuhet se ajo i ngarkohet AVUK-ut dhe se në këtë rast kemi përgjegjësi ndërshtetërore me Maqedoninë për arsye se sikur të mos ishte lëshuar certifikata gjegjësisht deklaracioni se bletët nuk kanë sëmundje infektive nuk do të kishte mundur me u realizuar importi si përfundim kjo është marrëveshje ndërkombëtare. Kurse sa i përket pranimit të mallit të gjithë përfituesit e mallit i kanë pranuar bletët dhe pas analizave atë ku është hasur se ekziston sëmundja janë ndërmarr masat e asgjësimit të bletëve.

Fatime Haziri, anëtare e kuvendit –tha se lidhur me shpërndarjen e bletëve, kishte me qenë mirë që drejtoresha përkatëse kompetente të na jep një informacion lidhur me ecurinë e kësaj çështje si dhe shkaqet që e kanë sjellë situatën deri këtu, më qëllim që të kemi një informim më të saktë dhe me të drejt.

Arta Haxhaj, drejtoresh e Drejtorisë për Ekonomi- paraqiti sqarime lidhur me informatën në fjalë duke sqaruar procedurat e kontraktimit dhe të importit të këtyre bletëve.

16. Të ndryshme.

16. a). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ridestiminin e mjeteve buxhetore të komunës.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 20 vota “për”, të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë Vendim bëhet ridestnimi i mjeteve nga buxheti i komunës në shumën prej 39,754.79€ nga fondi 10 (granti qeveritar) dhe fondi 21 (të hyrat vetanake) nga kategoria e investimeve kapitale, sipas tabelës 4.2, kodi i programit 180, Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile dhe Emergjencia.

2. Përmirësimi i vendimit në paragrafin 1 bëhet për shkak të permutacionit në numra të kolonës në tabelën 4.2 nga shifra 81,754.79€ në 39,754.79€.

3. Nga projektet e cekura në piken 1 të këtij Vendimi ridestinohen mjetet sipas tabelës 4.2 e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe i njëjti i dërgohet Ministrisë së Financave.

16. b). Shqyrtim i Propozim-vendimit për ndarjen e mjeteve nga fondi për transfere dhe subvencione.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

1.Me këtë Vendim, mjetet buxhetore të komunës –fondi për transfere dhe subvencione për vitin 2015, ndanë shumën prej 4.000€ (katër mijë euro) për KH “KOSOVA” (M) për zhvillimin e ndeshjeve ndërkombëtare që do të zhvillohen me datën 10 dhe 11 tetor 2015.

2.Mjetet në shumën e cekur si në piken paraprake ndahen në bazë të kritereve dhe kushteve të përcaktuara me Rregulloren për përcaktimin e kritereve të ndarjes së mjeteve financiare nga Fondi për transfere dhe subvencione për ndihmë momentale entiteteve publike dhe jo publike 01Nr.37-2/11,dt 24.02.2011, si dhe pas dorëzimit të raportit nga përfituesi nga ky fond për shfrytëzimin e mjeteve nga viti 2014.

3.Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen: Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport si dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

16. c). Shqyrtim i Propozim-vendimit për ofrimin e ndihmës financiare Qendrës për Mbrojtjen e Gruas dhe Fëmijëve “Raba Voca” në Mitrovicë.

Habibe Gërxhaliu, anëtare e kuvendit-tha se patjetër duhet të mbështetet kjo qendër, kur dihet se kemi të bëjmë me një kategori të rrezikuar të njerëzve. Mandej shtoi se pasi në këtë propozim janë pasqyruar shpenzimet në total për vitin 2016 që i bartë komuna jonë e që i dedikohen kësaj qendre, andaj nga kjo kërkoj që të ofrohet një informatë lidhur me numrin e fëmijëve dhe grave të strehuar në këtë qendër.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës-tha në këtë qendër trajtohen persona të cilët kanë një tretman jo të mirë në familjet e tyre të cilët janë shantazhuar dhe të maltretuar dhe të ngjashme. Tutje shtoi se në këtë qendër kryesisht kemi të bëjmë me strehim të përkohshëm dhe në rastet e rralla strehim më afatgjatë. Pastaj kjo qendër me seli në Mitrovicë e cila është regjionale, dhe se në të kaluarën komuna jonë e ka mbështetë me lëndë djegëse si ndihmës pasi nuk kanë pasur nevojë për më tepër. Mandej ai njoftoi se në të kaluarën kjo qendër kryesisht është subvencionuar nga donator ndërkombëtar por në këtë vit nuk ka pasur donator, dhe Komuna e Mitrovicës kësaj qendre i ka paguar shpenzimet e qirasë. Në vazhdimi ai njoftoi se me ndërmjetësimin e OSBE-së tri komunat kemi lidhur një memorandum bashkëpunimi dha atë Komuna e Vushtrrisë, Mitrovicës dhe Skenderajt, ku qëllimi kryesorë është që të ndihmohet kjo qendër, duke e subvencionuar në bazë të parametrave të pasqyruar në këtë marrëveshje. Në fund tha se kjo qendër duhet të ndihmohet, dhe ideja është që në të ardhmen kjo qendër duhet të jetë një “ndërmarrje sociale” regjionale, andaj kërkoj nga kuvendi që të votohet ky propozim.

Melihate Basholli, anëtare e kuvendit- kërkoj sqarime duke shtuar se tri kryetarët e Grupit të Grave ato të Vushtrrisë Mitrovicës dhe Skenderajt kanë pasur takim përmes OSBE-së disa herë dhe me Dr. Emine Kabashi që është udhëheqëse e kësaj qendre dhe se shumica e mjeteve financiare atëherë ka qenë më e vogël që është kërkuar por tani me siguri se janë futur edhe shpenzimet për vitin 2016. Pastaj ceku se dy çështje nuk i ka të qarta e para se nga viti 2016 kjo qendër do të kaloj me status si qendër shtetërore dhe çështja tjetër të informohemi se dy komunat tjera a i kanë ndarë mjetet për këtë qendër sipas obligimeve që i kanë marrë me marrëveshje.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendim lejohen mjetet buxhetore për ofrimin e ndihmës financiare Qendrës për Mbrojtjen e Gruas dhe Fëmijës “Raba Voca” në vlerën prej 2,508.80€, nga kategoria

subvencione dhe transfere (subvencione për raste të veçanta), nga zyra e kryetarit, për vitin 2015 për subvencionimin e një pjese të shpenzimeve të kësaj qendre.

2. Shuma e mjeteve financiare të cekura në pikën 1 të këtij vendimi ndahet për mbulimin e shpenzimeve për Qendrën për Mbrojtjen e Gruas dhe Fëmijës “Raba Voca” për pagesën e qirasë, energjisë elektrike dhe shërbimeve tjera publike.

3. Qendrës për Mbrojtjen e Gruas dhe Fëmijës “Raba Voca” i ndahen mjetet financiare për vitin 2016, në vlerën prej 3,834.88€ nga kategoria subvencione dhe transfere për mbulimin e shpenzimeve për ushtrim të veprimtarisë së kësaj qendre.

4. Obligohet Kryetari i Komunës që të nënshkruaj Memorandumin e Mirëkuptimit me Komunën e Mitrovicës së Jugut dhe Komunën e Skenderajt për subvencionim të përbashkët të qendrës në fjalë.

5. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohet: kryetari i komunës dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

16. ç). Pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit – tha se shumë qytetarë, ndër ta edhe babai i dy martirëve të luftës, Arif Zeka, ka ngritur shqetësimin e tyre në lidhje me mos përkujdesjen ndaj varrezave të Martirëve që gjenden afër varrezave të vjetra të qytetit në Vushtrri. Këto varreza janë në gjendje të keqe, ku sipas bacit Arif disa gurë në këto varreza tashmë janë të dëmtuara. Po ashtu, afër këtyre varrezave gjendet edhe një kontejner i madh i mbeturinave për fajin e të cilit, në afërsi të varrezave është krijuar një deponi e madhe e mbeturinave e cila e degradon edhe vet imazhin e varrezave të Martirëve.

Prandaj, ne kërkojmë që të mirëmbahet ky Kompleks dhe që urgjentisht të zhvendoset ai kontejner i mbeturinave nga ai vend.

Habib Mustafa, anëtar i kuvendit-paraqiti shqetësimin e tij lidhur me rrezikun që paraqet gropa në afërsi të shkollës me ç’ rast mund të rrezikohen nxënësit, lidhur me këtë problem ai kërkoj që në këtë lokacion të vendoset një rrethoj që të do të evitohet rreziku. Pastaj ai pyeti se përse nuk është përfunduar rrethoja e shkollës fillore në fshatin Zhilivodë por ajo ka mbetur në gjysmë, gjithashtu njoftoi se në fshatin Zhilivodë disa qytetar të pandërgjegjshëm e kanë përcjell kanalizimin në oborrin e shkollës kë kundërmon era jashtëzakonisht e keqe dhe ekziston rreziku i përhapjes së ndonjë sëmundje.

Syzana Sylja, anëtare e kuvendit – tha se kam marr një përgjigje nga DSHP-ja e cila është e mangët, dhe ri përsërit se në mbledhjen e kaluar kishte kërkuar nga DSHP-ja që ti ofrohet një informatë me shkrim për periudhën janar-qershor 2015 se cilët qytetarë kanë qenë përfitues të gypave të ujërave të zeza, çfarë sasive dhe çfarë dimensione të gypave si dhe në bazë të cilave kritere janë shpërndarë këta gypa nga ana e komisionit.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit – njoftoi kuvendin se në fshatin Karaçë rryma elektrike ia kishte mbytur tri lopë dhe ku në këtë rast viktimë do të kishte mundur të jetë edhe bariu i këtyre lopëve. Pastaj ceku se çdo ditë jemi dëshmitar dhe shohim se sa keq dhe pa kritere duke e shëmtuar imazhin e qytetit janë vendosur orëmatësit e energjisë elektrike nga ana e KEDS-it. Tutje shtoi se kjo po paraqet edhe rrezik për qytetarët për faktin se kjo vendosje është bërë me material të plastikës dhe që kanë filluar të dëmtohen dhe të bien poshtë. Andaj vlerësoi se kjo çështje duhet të aktualizohet që ndaj kësaj kompanie të ndërmerren masa konkrete sikurse kanë vepruar edhe disa komuna tjera.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit –pyeti lidhur me procesin e shqyrtimit të ankesave për emërtimin e rrugëve nga ana e komisionit përkatës i themeluar nga ana e kuvendit, komision i

cili siç duket nuk i ka dhënë rezultatet e pritura në punën e tij. Pastaj ai paraqiti shqetësimin e tij lidhur me emërtimin e rrugës me emrin "Shaban Tahiri" rrugë ndodhet në lagjen e tij, dhe emërtimi nuk është bërë në mënyrën më të mirë, andaj apeloj që komisioni emërtuar për këtë detyrë duhet të veproj dhe ta kryej punën e tij.

Safet Idrizi, anëtar i kuvendit-paraqiti shqetësimin e tij por edhe të qytetarëve tanë lidhur me qenët endacak, që ata e kanë përfshirë tërë qytetin dhe tani pasi është ftohur koha ata paraqesin rrezik permanent për shëndetin e qytetarëve. Tutja ai shprehu se e di që me ligji eliminimi i tyre është i ndaluar por me gjithë atë ceku se si kuvend janë përgjegjës që të kujdesen në preventiv për parandalimin e ndonjë tragjedie kishte me qenë mirë që brenda mundësive të gjendet ndonjë zgjidhje për eliminimin e tyre.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës-tha se lidhur me qenët endacak niveli qendrorë ka bërë një gabim që ka hartuar ligjin pa i krijuar kushtet dhe modalitetet e zbatimit të atij ligji, ata kanë menduar se kjo është punë e lehtë por nuk iu ka dalë ashtu si kanë menduar. Tutje njoftoi se komuna për dy herë radhazi ka shpallur tender për menaxhimin e qeneve për të përzgjedhur një kompani për menaxhimin e qeneve por askush nuk është paraqitur, për këtë çështje nuk ka të interesuar, dhe kjo në të vërtetë është një rrezik i vazhdueshëm që na përcjellë dhe sigurisht se rreziku do të jetë edhe më i madh gjatë stinës së dimrit në këtë rast u zotua se si kryetar komune do mundohet ta gjejë një metodë për menaxhimin e tyre. Pastaj duke ju përgjigjur anëtarit të kuvendit Ali Jonuzi njoftoi se shqetësimin e orëve elektrik e ka shtruar në Asociacionin e Komunave por edhe me Ambasadorin e Turqisë e cila e kishte ndihmuar dhe personalisht ishte ardhur në KEDS tek menaxheri kryesor dhe stafi i tyre për ta zgjidhur këtë problem dhe për këtë ka pasur fjalë të mira dhe premtime nga ambasadorja por edhe nga menxhmenti i KEDS-it, duke shprehu se janë të gatshëm për rregullimin e këtij problemi por deri me sot asgjë nuk është bërë. Lidhur me këtë çështje njoftoi se kanë formuar komisione mikste profesionale mes zyrtarëve të KEDS dhe atyre komunale por akoma nuk ka rezultatet konkrete përndryshe ka urdhëruar inspektoratin komunal që mos të lejojnë vendosjen e këtyre orëve. Mandej tek mbytyja e lopëve theksoj se e ka lexuar këtë informacion dhe se kjo ndërlihet me infrastrukturën tepër të dobët të rrjetit elektrik në gjithë territorin e komunës sidomos në viset rurale. Lidhur me emërtimin e rrugëve dhe shqyrtimin e ankesave njoftoi se komisioni i ngritur lidhur me këtë çështje është duke e kryer punën e tij dhe prej afro 300 ankesave të ushtruara kanë mbetur vetëm 60 pa u shqyrtuar dhe trajtuar në mënyrë përfundimtare. Pastaj lidhur me kriteret për shpërndarjen e gypave do të sjellim listën e përfituesve të këtyre gypave. Mandej lidhur me kanalizimin në fshatin Zhilivodë do të formohet një komision dhe do të konstatohet gjendja faktike atje dhe do të identifikohen masat të cilat do të ndërmirën, kurse lidhur me rrethojnë e shkollës në fshatin Zhilivodë ky projekt ka mbetur në gjysmë për faktin se nuk ka pasur mjetë më shumë për tu kryer ajo rrethoj dhe për këtë nevojitet të kemi mjetet të barten me vendim të kuvendit dhe të zhvillohet një projekt i ri për përfundimin e asaj rrethoje. Pastaj lidhur me gropën tek shkolla e fshatit Stroc do të dërgohen inspektorët komunalë për të parë gjendjen e asaj grope dhe duhet të konstatohet rreziku për tu propozuar masat adekuate. Si dhe në fund sa i përket mirëmbajtjes së Varrezave të Martirëve dhe kontejnerit tha se është keq kjo dhe duhet të rregullohet , dhe sidomos tash pasi është aprovuar plani dhe rregullorja për menaxhimin e mbeturinave, ndërsa lidhur me meremetimin e varrezave njoftoi se për vitin e ardhshëm janë propozuar mjete për rregullimin e tyre.

Mbledhja përfundoi në orën 15:10.


Bastri Duraku



Procesmbajtës



Shpëtim Zhegrova



Kryesues i Kuvendit